

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	25/05/2025	Në zbatim të ligjit nr. Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar; Ligjit nr. 127/2024, “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 9.5.2025 “Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara”, kërkoj të informohem zyrtarisht nga ana juaj, nëse Kundravajtjet e vendosura në vitin 2016, (ende të paekzekutuara) nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, Dega Rajonale, Qarku Tiranë, përfshihen në parashikimet ligjore të VKM 274/dt.09.05.2025, për Vendimet e dënimit me gjobë për lëndë ndrusore, për individë që <u>kanë objekt të aktivitetit të tyre prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale.</u> Nëse po, kërkoj të informohem cili është Autoriteti Përkatës të cilit unë si individ duhet t’ i drejtohem për këtë verifikim.	25/05/2025	Duke ju referuar kërkesës tuaj për sqarim/interpretim dhe jo për informim konkretisht lidhur me pyetjen a janë falur nga ligji nr. 127/2024 gjobat e vendosura nga ish Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave dhe Degët Rajonale të ISHMPU, në respektim të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ju bëj me dijeni sa vijon: Referuar ligjit nr. 127/2024, gjobat e vendosura nga ish ISHMPU, të paekzekutuara, ku sipas rastit me zëvendësim procedural nga gjykata kompetente ose përmbarimi gjyqësor gjobat e vendosura nga ish Inspektoriati i Policisë	E plotë	Nuk ka

			Pyjore të ISHMPU i kanë kaluar Agjencisë Kombëtare të Pyjeve në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nuk janë objekt i zbatimit të këtij ligji. Dënimi administrativ me gjobë është dhënë për shkelje të kërkesave ligjore për transportin apo tregtimin e lëndës drusore dhe jo për prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale ku lënda drusore nuk është produkt pyjor dhe as bujqësor e as blegtoral. Për sa më lart të gjitha dënimet administrative kryesore me gjobë të vendosura nga trupat inspektuese të mjedisit, pyjeve dhe ujërave të ish ISHMPU, Drejtorisë Qendrore dhe 12 Degëve Rajonale, të cilat nuk janë ekzekutuar, nuk janë falur, ku gjobat e mjedisit dhe ujërave i kanë kaluar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit,		
--	--	--	---	--	--

				Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,		
02	26.05.2025	Sa kërkesa për informacion janë kryer që nga 2021-shi në institucionin tuaj? Sa prej këtyre kërkesave për informacion i është kthyer përgjigje brenda afatit 10 ditor? Sa nga këto kërkesues i janë ankuar Komisionit për të drejtën e informimit?	28.03.2025	Përgjigja Nr.1 : Në bazë të VKM nr. 584, datë 22.7.2020 “<i>PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PYJEVE</i>“, Agjencia Kombëtare e Pyjeve e ka zhvilluar rolin e saj si agjenci nga fundi i <i>vitit 2020</i> dhe për këtë arsye si një institucion i ri e në zhvillim nuk rezulton të jenë regjistruar kërkesa për informacion në regjistrat respektiv Për Të Drejtën e Informimit. Kërkesat për informacion fillojnë prej fillimit të <i>vitit 2022</i> dhe deri më sot. Që nga <i>viti 2022</i> deri në <i>maj te vitit 2025</i> pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve janë drejtuar gjithsej 38 kërkesa, ku 6 prej tyre janë deleguar në institucionet e kompetencës për trajtim. Përgjigja Nr.2 : Në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve janë drejtuar gjithsej 38 kërkesa që nga <i>viti 2022- Maj 2025</i>. Brenda afatit 10 ditor në	E Plotë	Nuk ka

			bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për Të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, iu janë kthyer përgjigje 34 kërkesave për informim , ku 4 prej të cilave janë trajtuar jashtë afatit për arsye të natyrës komplekse dhe volumit të kërkesës për informacion, rrethanë që i është vënë në dijeni palës së interesuar. Përgjigja Nr.3 : Përgjatë gjithë veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve nuk ka pasur asnjë ankim drejtuar nga pala kërkuese tek Komisioneri Për Të Drejtën Për Informim.		
--	--	--	--	--	--